

Mars - Qershor 2010

KOKSH Informacione



KOMITETI OLIMPIK
KOMBETAR SHQIPTAR



Piktura e realizuar nga nxënësi Ani Kristo, fitues i konkursit "Olimpizmi në penelatat tona"



Lojrat Olimpikë Rinore

SINGAPOR 2010

14-26 Gusht 2010

10 Mars

Konferencë për shtyp, Ceremoni Post “Vancouver 2010”

Në datë 10 Mars 2010 në zyrat e KOKSH u zhvillua Ceremonia Post-Olimpiadë “Vancouver 2010”. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin:

Presidenti i KOKSH z. Agim Fagu, protagonistin e Shqipërisë në Olimpiadë skiatori Erjon Tola, Shefi i Misionit Shkëlqim Memaj, anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, përfaqësues të Federatës Shqiptare të Skive, media, miq dhe familjarë të Erjonit.



Pas prezantimit nga Erjoni dhe Presidenti i KOKSH të eksperiencës në Olimpiadën e Vancouver para të pranishmëve, një interes të vecantë pati media për tu informuar mbi vazhdimësinë e përgatitjes së Erjonit për Lojërat e ardhshme Olimpikë Dimërore “Sochi 2014”.

12 Mars

Takim KOKSH – MTKRS

Në datë 12 Mars 2010, në Ministrinë e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve u zhvillua një takim pune ndërmjet Ministrit z. Ferdinand Xhaferri dhe titullarëve të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar z. Agim Fagu - President dhe z. Stavri Bello- Sekretar i Përgjithshëm. Në takim u diskutuan tema të partneritetit ndër-institucional në dobi të forcimit dhe përsosjes së komunikimit dhe bashkëpunimit në fushën e sportit dhe Olimpizmit. Një vend të rëndësishëm zuri edhe diskutimi mbi përmirësimin e Kuadrit Ligjor në funksion të krijimit të hapësirave për zhvillimin e sportit nga të dy palët.

Lidhur me problemin e Federatave sportive paralele, të dy palët ranë dakord që të respektohen vendimet e organeve kompetente ligjore .

MBLEDHJE DHE TAKIME TE NDRYSHME NE KOKSH

Mbledhje të Komisionit Teknik të KOKSH

Komisioni Teknik i KOKSH ka patur një axhendë të ngjeshur pune, në kuadër të Lojërave Olimpikë Rinore “Singapor 2010” dhe afrimit të Lojërave Olimpikë Verore “Londër 2012”. Në takimet e tij, ka patur të ftuar edhe nga Federatat Sportive Olimpikë që bëjnë pjesë në programin e LOR “Singapor 2010”, ku Shqipëria do të përfaqësohet në sportet Atletikë, Xhudo, Vozitje dhe Not, të përcaktuara nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, por gjithashtu ka shqyrtuar edhe mundësitë për sportistë që do mund të arrijnë normat në garat kualifikuese. Një çështje tjetër me rëndësi në punën e Komisionit ka qenë shqyrtimi i sportistëve kandidat që do të jenë përfitues të bursave Olimpikë për Sportistë “Londër 2010”, bazuar mbi kandidaturat dhe informacionin e sjellë nga federatat respektive.

Datat e mbledhjeve të komisionit 25 Mars/22 Prill/29 Prill/19 Maj /03 Qershor / 24 Qershor.



18 Mars /30 Prill / 24 Maj Mbledhje të KE të KOKSH

Komiteti Ekzekutiv i KOKSH ka zhvilluar një aktivitet të ngjeshur dhe aktiv këtë periudhë ku është dashur të merren vendime të rëndësishme për veprimtarinë e KOKSH në vijim. Ndër pikat që janë diskutuar: Raportim mbi Lojërat Olimpike Dimërore “Vancouver 2010”, përgatitja për Lojërat Olimpike Rinore “Singapore 2010”; miratimi draftit final të Statutit të KOKSH; njohja me procedurat e KAS; projekt buxheti financiar 2010, mbi përcaktimin e delegacionit zyrtar për LOR “Singapor 2010”, përcaktimin e listës së Bursave Olimpike për sportistë “Londër 2010”, shqyrtimin e kërkesës për anëtarësim të disa shoqatave, informacione mbi kurset e administratorëve Lokalë në Sarandë dhe Kukës, si dhe lancimi i Advanced Sport Management Course, info mbi aktivitete Olimpike të organizuara nga KOKSH, etj.

29 Mars Mbledhje e komisionit Finance –Marketing

Anëtarët e Komisionit Financë- Marketing të KOKSH u mbledhën ditën e Hënë, datë 29 Mars 2010 në zyrat e KOKSH për të zhvilluar mbledhjen e tyre të radhës.

Pika kryesore e diskutimeve u përqendrua rreth projekt - buxhetit financiar 2010.

2 Prill Mbledhje Komisioni “Femra & Sporti”

Në datë 02 Prill 2010 në zyrat e KOKSH, me kërkesë të kryetares së Komisionit “Femra dhe Sporti” të KOKSH, znj. Hyrmete Gjeta, u zhvillua mbledhja e radhës e këtij komisioni. Në këtë mbledhje mes të tjerash u diskutua për disa projekte konkrete të komisionit për vitin 2010, si dhe për iniciativa të ndryshme në lidhje me promovimin e femrës në sport.

6 Prill Mbledhje komisioni “Sporti për të Gjithë”

Komisioni “Sporti për të Gjithë” i KOKSH i drejtuar nga znj. Majlinda Pilinci, në datë 06 Prill 2010 zhvilloi mbledhjen e parë të tij për 2010. Anëtarët, diskutuan për rritjen e rolit të komisionit si dhe iniciativa të ndryshme në lidhje me promovimin e Sportit për të Gjithë, përmes veprimtarive të iniciuara nga vetë komisioni apo bashkëpunime me partnerë të tjerë nën kujdesin e komisionit.

30 Qershor Mbledhje e Komisionit të Kualifikimit

I drejtuar nga znj. Ela Tase, Komisioni i Kualifikimit të KOKSH ka zhvilluar mbledhjen e parë për 2010. Referuar edhe përvojës së mëparshme komisioni ka në përbërje të tij anëtarë nga sfera akademike gjë e cila e bën edhe më funksional punën e tij. Misioni i Komisionit është që në bashkëpunim me partnerët e KOKSH të hartoj një politikë të shpërndarjes së mundësive për kualifikime të ndryshme sipas nevojave të anëtarëve.

13 Maj Akademia Olimpik Shqiptare

Pas një periudhe të fundit jo shumë aktive, AOSH ka filluar të riorganizohet. Komiteti Ekzekutiv i KOKSH ka zgjedhur Drejtorin e ri z. Anesti Qeleshi i cili ka qenë për një kohë të konsiderueshme anëtar i Bordit të saj. Në mbledhjet e organizuara është miratuar kalendari i veprimtarive për 2010 dhe plani i riorganizimit.

31 Mars Krijimi i Komitetit Olimpik Rajonal

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, përfaqësuar nga Presidenti tij z. Agim Fagu dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Stavri Bello në datë 31 Mars 2010 ishin në qytetin e Sarandës, ku me iniciativën e një grupi vullnetar të drejtuar nga z. Xhorxhi Vasili, në Hotel Butrinti zhvilluan një takim me përfaqësues të botës së sportit si dhe persona të tjerë me kontribut të shquar në fusha të tjera, por me dëshirë dhe pasion për Olimpizmin. Në takim morën pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, Kryetari i Bashkisë së Sarandës z. Edmond Gjoka, nën Prefekti dhe Kryetari i Bashkisë së Delvinës.



Qëllimi i takimit u finalizua me krijimin e **Komitetit Olimpik Rajonal të Sarandës** ku Asambleja zgjodhi Komitetin Drejtues dhe President z. Eduart Mehmeti.

Z. Agim Fagu përshëndeti këtë iniciativë dhe i uroi punë të mbarë KOR të Sarandës.

Takimi u parapri nga organizimi i Ditës Olimpike të Vrapimit, ku morën pjesë nxënës të përzgjedhur të shkollave 9-vjecare të qytetit. Dita Olimpike Sarandë hapi sezonin e organizimit të këtij aktiviteti, i cili do të pasohet në vazhdim edhe në qytete të tjera të Shqipërisë.



21 Prill

Ndahet nga jeta Juan Antonio Samaranch

Ish-Presidenti i CIO dhe President Nderi përjetë i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar - Juan Antonio Samaranch u nda nga jeta në moshën 89 vjecare.

Juan Antonio Samaranch shërbeu si Presidenti i 7të i CIO nga 1980-2001 dhe u zgjodh President Nderi përjetë në 2001. Ai është konsideruar si transformuesi i madh i Lojërave Olimpike, si një figurë dominuese në Lëvizjen Olimpike moderne, i cili e udhëhoqi atë për më shumë se 21 vjet.

KOKSH shpreh keqardhjen e humbjes së një njeriu të madh që i ka dedikuar jetën e tij Lëvizjes Olimpike dhe ka qenë frymëzues për shumë anëtarë të Familjes Olimpike e më gjerë.

Kujtojmë se z. Samaranch, President i CIO ka vizituar Tiranën zyrtare në vitin 1984 dhe 1995, i cili ka zhvilluar takime të rëndësishme me përfaqësues të lartë të shtetit.

KOKSH shpreh mirënjohjen për kontributin dhe vëmendjen e z. Samaranch ndaj Shqipërisë.



27 Prill

Promovimi i librit “Avni Zajmi – Kronikë e një jete shekullore”

Në datë 27 prill 2010, në ambjentet e Universitetit të Sporteve të Tiranës u organizua promovimi i Librit “**Avni Zajmi – Kronikë e një jete shekullore**” me autor z. Genc Zajmi. Në ceremoninë e promovimit të librit, e cila për nga mënyra e organizimit ishte në formën e një sesiioni shkencor, ishin të pranishëm titullarët e KOKSH, Rektori i UST, familjarë, miq, kolegë dhe nxënës të Mësuesit të Popullit Avni Zajmi.

Disa nga të pranishmit në fjalën e tyre sollën në kujtesë disa aspekte të jetës, figurës dhe veprimtarisë së tij.





15 Maj

Krijohet Federata Ballkanike e Sportit për të Gjithë - znj. Majlinda Pilinci zgjidhet zv. Presidente

Në Stamboll të Turqisë, në datat 14-17 Maj 2010, u zhvillua takimi për rikrijimin e Federatës Ballkanike Sporti për të Gjithë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Turqia, Bullgaria, Serbia, Rumania, Mali i Zi dhe Shqipëria. KOKSH u përfaqësua në këtë takim me znj. Majlinda Pilinci, me statusin e anëtares së Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, Kryetares së Komisionit SPGJ të KOKSH dhe njëkohësisht Sekretarës së Përgjithshme të Federatës Shqiptare të SPGJ.

Në këtë takim u miratua Statuti i Federatës / Shoqatës Ballkanike Sporti për të gjithë (BSFAA- Balkan Sports for All Association) pasardhëse e Federatës të themeluar në 17 Nëntor të vitit 1995, në Sofie të Bullgarisë, e cila ka funksionuar deri përpara disa vitesh. Në përfundim, Znj. Majlinda Pilinci u zgjodh një nga zv/Presidentet e kësaj organizate.

20 Maj

Forumi UN – CIO në Lozanë

Për herë të parë u zhvillua një forum i përbashkët midis Kombeve të Bashkuara (UN) dhe CIO, në datë 20 Maj, në Muzeun Olimpik në Lozanë.

Forumi, i titulluar “**Rëndësia e partneritetit**”, mbledhi së bashku zyrtarë të lartë të sportit botëror dhe përfaqësues të UN, për të vënë në dukje statusin e ri të CIOs si vëzhgues në UN, si dhe për të forcuar bashkëpunimin në fushën e zhvillimit nëpërmjet sportit.

Në këtë forum mes përfaqësuesve të Komiteteve Olimpikë Kombëtare ishte edhe Presidenti i KOKSH, z. Agim Fagu.

Prill-Maj

ASMC

Ka marrë rrugë projekti i radhës i Solidaritetit Olimpik që ka të bëjë me kualifikimin e avancuar të administratorëve sportivë: **ASMC – Kurs i Avancuar për Menaxhimin Sportiv.**

Kualifikimi vazhdueshëm i burimeve njerëzore në sport sot është një prioritet dhe për këtë qëllim KOKSH e ka parë me përparësi organizimin e tij madje ka kërkuar edhe partneritet me MTKRS dhe UST. Nëpërmjet njoftimit të hapur KOKSH ka ftuar të aplikojnë të gjithë ata individë që kontribuojnë apo punojnë pranë organizatave sportive, që dëshirojnë të kenë staf të kualifikuar dhe që dëshirojnë progresin duke patur një vështrim bashkëkohor mbi menaxhimin e organizatave sportive. Tashmë regjistrimet kanë përfunduar dhe është konfiguruar grupi që do të ndjekë kursin i cili do të fillojë më 18 Shtator 2010. Grupi i facilitatorëve që do të drejtojnë kursin kanë bërë një punë paraprake duke u mbledhur periodikisht, por e veçanta është se për cdo modul do të jenë të ftuar lektorë të huaj me përvojë të suksesshme në menaxhimin sportiv.

Në mbarim të kursit, pjesëmarrësit do të pajisen me Diplomë Profesionale të Avancuar për Menaxhimin e Organizatave të Sporteve Olimpikë, lëshuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC).



(Advanced Sport Management Course_

ASMC ofron një mundësi të vecantë për personat që punojnë në organizatat sportive, të nivelit ekzekutiv, vullnetarë apo anëtarëve të stafit me pagesë, të zgjerojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre menaxheriale dhe njëhësisht të kontribuojnë aktivisht në një bashkësi unike që mëson nga njëri-tjetri. Metoda me pjesëmarrje do të ndihmojë në rritjen e aftësive menaxheriale të pjesëmarrësve.

Programi i ASMC është projektuar të trajtojë ato aftësi që janë specifike për fushën e sportit dhe është dizenuar për të trajnuar një ekip administratorësh sportivë të aftë për të kryer në menyrë profesionale rolin e tyre.

Ky është një program me gjashtë module ku përfshihen ditë mësimi në distancë dhe ditë mësimi intensive në klasë. Përmbajtja e lëndës do të ofrojë kursantëve, njohuri më të fundit mbi menaxhimin sportiv dhe aftësi të cilat do të rrisin kapacitetet e tyre menaxhuese.



22 Qershor

Sergei Bubka vizitë në KOKSH

Z. **SERGEI BUBKA**, Zv. President i Federatës Botërore të Atletikës (IAAF), njëkohësisht President i Komitetit Olimpik të Ukrainës dhe Anëtar i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (CIO), dhe z. Bruno Gozzelino, President i Shoqatës Ndërkombëtare të Vrapimit në Mal, zhvilluan më datë 22 Qershor një vizitë të shkurtër pune dhe intensive në Tiranë.



Me një axhendë të ngjeshur, z. Bubka zhvilloi një vizitë në zyrat e KOKSH i shoqëruar nga Presidenti i Federatës Shqiptare të Atletikës z. Gjergj Ruli dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Nikolin Dionisi. Ata u pritën nga zv. Presidentja e KOKSH znj. Ela Tase dhe anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH.

Z. Bubka shprehu falenderimet e tij për pritjen e ngrohtë si dhe për mbështjetjen që do ti jepet nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar organizmit të Kampionatit Botëror të Vrapimit në mal, i cili do të zhvillohet në 2011 në Malin e Dajtit.

z. Bubka në një konferencë për shtyp organizuar në KOKSH bëri para mediave një rezumë të shkurtër të takimeve të tij me titullarë të shtetit shqiptar duke i përshkruar ato si mjaft të frutshme dhe mbështetëse, jo vetëm për aktivitetin e rëndësishëm të Kampionatit Botëror të Vrapimit Malor, por edhe ndaj sportit në tërësi, sidomos në politikën për zhvillimin e sportit dhe përfshirjen e brezit të ri në aktivitete sportive.

6 Qershor 2010

KURSI LOKAL I ADMINISTRATOREVE SPORTIVE - SARANDE

Në ambjentet e Universitetit të qytetit të Sarandës u zhvillua Kursi Lokal për Administratorët Sportivë i organizuar nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar në bashkëpunim me Klubin e Sportit Butrinti. Me pjesëmarrës të specialistëve të sportit në Bashki, Klubit Sportiv dhe mësues të edukimit fizik të qytetit të Sarandës, Ksamilit dhe Livadhjasë, kursi kishte për qëllim dhënien e njohurive në fushën e administrimit në sport. Në ceremoninë e hapjes dhe mbylljes përshëndetën Kryetari i Bashkisë z. Edmond Gjoka, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello dhe Kryetari i Komitetit Olimpik Rajonal Sarandë z. Eduart Mehmeti duke i dhënë një rëndësi të vecantë organizimit të këtij kursi. Ata vlerësuan përpjekjet e KOKSH dhe gjithashtu materialet e trajtuara u quajtën mjaft të vlefshme për punën e pjesëmarrësve.



Temat e kursit ishin të larmishme dhe përfshinin :

Roli i administratorit në një organizatë sportive, Menaxhimi financiar, Komunikimi, Etika në sport dhe organizatat sportive, Marketingu sportiv, Sporti dhe Media, Organizimi i ngjarjeve sportive, Edukimi Olimpik. Temat sipas fushës përkatëse provokuan diskutime ndërmjet pjesëmarrësve gjë që ishte shumë interesante pasi edhe modeli i këtyre kurseve kërkon pjesëmarrjen aktive.



10 Qershor 2010

KURSI LOKAL I ADMINISTRATOREVE SPORTIVE - KUKES

Në vijim të projektit të Solidaritetit Olimpik për zhvillimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore që operojnë në fushën e sportit, KOKSH vijoi me programin në qytetin e Kukësit, ku Kursi Lokal për Administratorët Sportive, u organizuar në bashkëpunim me Klubin e Sportit të qytetit .

Kishte 24 pjesëmarrës specialistëve të sportit në Bashki, Klubi Sportiv dhe mësues të edukimit fizik të qytetit dhe komunave të Kukësit, si Bicaj, Shishtavec, Has, etj. Ashtu si në qytetin e Sarandës edhe në Kukës, temat e leksioneve ishin të përafërta. Temat gjithashtu provokuan diskutime ndërmjet pjesëmarrësve por një tjetër aspekt pozitiv i këtij kursi ishte dhe fakti i mbledhjes së specialisteve që të diskutojnë me njeri-tjetrin dhe të ndajnë eksperiencat e tyre. Element tjetër pozitiv ishte edhe mundësia për të njohur disa praktika të mira që organizohen nga individë apo në rajone të caktuara, por gjithsesi kanë nevojë të promovohen.

Kursi i cili është në vazhdim të projekteve të Solidaritetit Olimpik për përmirësimin dhe kualifikimin e kadrove sportive që të pajisen me njohuri bazë menaxheriale dhe administrative, do të vijojë sipas strategjisë së KOKSH në përputhje me programin e Solidaritetit Olimpik edhe në disa qytete të tjera deri në fund të vititi.



Pjesëmarrësit në përfundim të kursit



Punë në grup

29 Qershor KOKSH partner në organizimin e parë të kursit për specialist të qëndrave të fitnesit.

Kursi i parë i specialistëve të këtij lloji vjen si iniciativë e drejtpërdrejtë e H-Consulting, i mbështetur nga Universiteti i Sporteve të Tiranës dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

Ky program është një specializim i kohës së sotme moderne të qëndrave të ndryshme të Fitnesit, stërvitore dhe ato kuruese, e për më gjerë të qëndrave të mëdha Rekreative Sportive, tashmë të njohura në Europë si (Wellness Center / Centro Benessere) të cilat së fundi po fillojnë të gjejnë treg edhe në Shqipëri.

Përmbledhje e aktiviteteve të zhvilluara nga KOKSH në kuadrin e projektit të Edukimit Olimpik

Këto aktivitete janë zhvilluar në disa qytete të Shqipërisë me tematika të ndryshme.

Falenderojmë partnerët tanë në realizimin e tyre : MASH, Drejtoritë Arsimore në rrethe, Komitetet Olimpik Rajonale, Bashkitë dhe Klubet Shumspportëshe të qyteteve përkatëse, dhe veçanërisht sponsorat tanë në këtë projekt: Kompania e Sigurime Inter Albania dhe Coca Cola Bottling Shqipëria.

4 Maj	Luaj e Mbaj Pastër Mjedisin” Kodrat e liqenit artificial, Tiranë,
6 Maj	Edukimi Olimpik “Rubik 2010”
10 Maj	Dita Olimpikë “Gjirokastrë 2010”
13 Maj	Dita Olimpikë në shkollën “Harry Fultz”
26 Maj	Edukimi Olimpik “Durrës 2010”
28 Maj	Edukimi Olimpik në shkollën “Herman Gmeiner” Fshati SOS
31 Maj	“SPORT PA DUHAN” Motoja e një jetë të shëndetshme
15 Qershor	Konkursi dhe Ekspozita: OLIMPIZMI NË PENELATAT TONA



Cfarë janë LOR?

Lojërat Olimpike Rinore janë një ngjarje sportive për të rinj, që balancon sportin, edukimin dhe kulturën. Këto lojëra veprojnë si katalizator për të gjithë Lëvizjen Olimpike.

Vizioni

Vizioni i Lojërave Olimpike Rinore është të frymëzojë të rinjtë në mbarë botën të marrin pjesë në sport dhe të adoptojnë e të jetojnë sipas vlerave Olimpike. Gjatë sesionit të saj në Guatemalë në Korrik 2007, IOC vendosi të krijojë një ngjarje të re sportive për të edukuar, përfshirë dhe ndikuar sportistët e rinj, duke i frymëzuar ata të luajnë një rol aktiv në komunitetet e tyre.

Objektivat e LOR janë:

- të sjellë së bashku sportistët e rinj më të mirë të botës dhe ti vlerësojë ata
- të ofrojë një prezantim të fuqishëm dhe unik të Olimpizmit
- të sjellë risi në edukimin dhe debatimin e vlerave Olimpike dhe sfidave të saj në shoqëri
- të festojë së bashku kulturat e botës në një atmosferë festive
- të arrijë tek komunitetet në mbarë botën për të promovuar vlerat Olimpike
- të rrisë ndërgjegjësimin sportiv dhe pjesëmarrjen e të rinjve
- të veprojë si platformë për iniciativa brenda Lëvizjes Olimpike
- të jetë një ngjarje e standarteve më të larta sportive ndërkombëtare

Kush? Cfarë? Kur?

Lojërat Olimpike Rinore synojnë të sjellin së bashku sportistë të talentuar – nga mosha 14 deri 18 - nga e gjithë bota, për të marrë pjesë në gara të niveleve të larta, por gjithashtu, së bashku me elementet sportive në këtë ngjarje, të zhvillojë programe edukuese mbi vlerat Olimpike, përfitimet nga sporti për një mënyrë jetese të shëndetshme, vlerat sociale që mund të transmetojë sporti dhe rreziqet e dopingut dhe stërvitjes së tepruar apo edhe pasivitetit.

Lojërat e para Olimpike Rinore do të sjellin së bashku rreth 3,200 sportistë dhe 800 zyrtarë në 2010. Programi sportiv do të përfshijë të 26 sportet e programit të Lojërave Verore të 2012, me një numër të kufizuar disiplinash dhe veprimtarish. Lojërat e para Dimërore Rinore do të sjellin së bashku rreth 1,000 sportistë dhe 500 zyrtarë. Sportistët do të konkurojnë – për herë të parë në 2012 – në të shtata Sportet Olimpike Dimërore. YOG do të ndjekë ciklin tradicional të katër vjetëve, më Lojëra Verore në 2010, 2014, 2018 etj dhe me Lojëra Dimërore në 2012, 2016, 2020 etj.

Singapori mikpritës i Lojërave të para Olimpike Rinore Verore në 2010

Singapori do të mirëpresë Lojërat e para Olimpike Rinore Verore në 2010. Rezultati i zgjedhjes i bazuar në vlerësimin e 105 anëtarëve të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC) me të drejtë vote, u bë publik në 21 Shkurt 2008 nga Presidenti i IOC Jacques Rogge në Muzeun Olimpik në Lozanë.

Pas LOR Verore (I) në 2010 vijnë LOR Dimërore (I) në 2012

IOC ka nisur procesin e hedhjes së kandidaturave për Lojërat e para Olimpike Rinore Dimërore në 2012. Një letër i është dërguar të gjitha Komiteteve Olimpike Kombëtare (NOC), duke i informuar ata për procedurën dhe dokumentacionin në dispozicion për qytetet e interesuara në konkurimin për Lojërat.

Adresa: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Rr. "Muhamed Gjollësja",
Sheshi "Mustafa K. Atatürk" (ish 21-dhjetori), Tiranë-Albania
Tel: +355 4 2235 249 / 2240 602, Fax: +355 4 2240 565
e-mail: secretariat@nocalbania.org.al / www.nocalbania.org.al